



AKTI I THEMELIMIT  
& SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"KRONOS KONSTRUKSION", "SH.P.K", "ORTAK I VETEM"

( K o n t r a t e )

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Shoqeria Tregtare "KRONOS KONSTRUKSION", "SH.P.K.", "ORTAK I VETEM", themelohet nga VASIL JOVANI, i biri i Spiros, lindur ne 25.08.1963, ne Gjirokaster, banues ne Tirane. Rruga "Mihal Grameno", Nr.1, me pashaporte Nr.0129350, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Neni 2

Shoqeria Tregtare "KRONOS KONSTRUKSION", "SH.P.K.", "ORTAK I VETEM", eshte person juridik, i njohur me ligj dhe i regjistruar ne regjistrin tregtar ne Gjykatën e Shkalles se pare te Tiranës dhe ne organet financiare te rrethit Tirane.

Neni 3

Shoqeria Tregtare "KRONOS KONSTRUKSION", "SH.P.K.", "ORTAK I VETEM", e ka qendren e saj ne qytetin e Tiranës. Ajo mund te hap filiale, desge e perfaqesi ne qytete te tjere te Shqiperise dhe jashte saj.

Neni 4

Shoqeria Tregtare "KRONOS KONSTRUKSION", "SH.P.K.", "ORTAK I VETEM", funksionon ne baze te neneve te ketij Akti, Statutit te bashkengjitur, legjislacionit shqiptar ne fuqi, vecanesrisht ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerit tregtare", si dhe akteve nderkombetare te njohura nga legjislacioni shqiptar.

Neni 5

Shoqeria Tregtare "KRONOS KONSTRUKSION", "SH.P.K.", "ORTAK I VETEM", perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar, sic eshte parashikuar ne nenin 37 te ligjit "Per shoqerit tregtare".

Neni 6

Shoqeria Tregtare "KRONOS KONSTRUKSION", "SH.P.K.", "ORTAK I VETEM", eshte e lire te bashkepuoje me persona te tjere juridike e fizike, shqiptar ose te huaj, per kryerjen e nje pjese apo te shume aktiviteteteve te saj.

Neni 7

Shoqeria Tregtare "KRONOS KONSTRUKSION", "SH.P.K.", ushtron veprimtari te ndryshme ndertimore.

Neni 8

Marrja ne pune ne Shoqerin Tregtare "KRONOS KONSTRUKSION", "SH.P.K.", behet me kontrate, ne te ciklen percaktohen te drejtat dhe detyrimet e paleve ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe rregullon marredheniet e punes.

Neni 9

Shoqeria Tregtare "KRONOS KONSTRUKSION", "SH.P.K." merr persiper zbatimin e dispozitave ligjore per sigurimet shoqerore dhe atyre per mbrojtjen dhe sigurimin ne puyne. Per kete qellim ajo krijon fonde te vecanta dhe lidh marreveshje me organet shteterore perkatese.

Neni 10

Mosmarreveshjet qe lindin nga kontrata e punes do te zgjidhen nga Gjykata ne baze te rregullave te caktuar ne kontrate dhe ne dispozitat qe rregullojne marredheniet e punes - Kodin e Punes.

Neni 11

Shoqeria Tregtare "KRONOS KONSTRUKSION", "SH.P.K.", ka emerine e vet, konforme legjislacionit perkates.

Neni 12

Objekti i aktivitetit te shoqerise eshte :

- a) Veprimtari per projektim dhe ndertime e rikonstruksione te veprave industriale e sociale.
- b) Veprimtari per projektim dhe ndertime banesash shume katshe dhe vilash.
- c) Veprimtari per projektim dhe ndertim veprash urbane, rruge e kanalizime.
- d) Veprimtari per sherbime publike per panaire, ekspozita.

Neni 13

Kapitali themeltar fillestar i Shoqerise eshte 100.000 leke. Ky fond ne para eshte depozituar per ilogari te Shoqerise tek Noter Donika Koni dhe qe vertetohet me dokumentin noterial Nr. 2, date 19. 03, 2002, i cili i bashkengjitet dokumentacionit ne themelim te Shoqerise,

konforme nenit 40 te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

**Neni 14**

Ortaku i vetem, pas krijimit te Shoqerise, ka te drejte te zmadhoje kapitalet me ane te kontributeve ne para, konforme nenit 62 te ligjit Nr 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

**Neni 15**

Ortaku i vetem, pas krijimit te Shoqerise, ka te drejte te vendose edhe kontribute ne natyre. Keto do te vleresohen nga raporti i eksperteve te emeruar nga Ortaku i vetem, konforme nenit 42 te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare". Raportet e eksperteve i bashkengjiten dokumentacionit pas krijimit te saj.

Gjithashtu Ortaku i vetem ka te drejte edhe ta zmadhoje kapitalin me ane te kontributeve ne natyre, konforme kerkesave te nenit 03 te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

**Neni 16**

Ne qofte se Shoqeria nuk themelohet brenda nje afati prej gjashte muajsh, duke filluar nga data r depozitimit te fondeve, kontribuesi ka te drejte te kerkoje ne rruge gjyqesore terheqjen e shumes se kontributit, konforme nenit 41 te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

**Neni 17**

Shoqeria eshte pronare e pasurive te saj dhe ka te drejten e perdorimit dhe te disponimit te kesaj pasurije ne perputhje me objektin dhe qellimin e veprimtarise se saj.

**Neni 18**

Shoqeria krijon fonde te vecanta financimi. Burimet e krijimit te ketyre fondeve dhe perdorimin e tyre e percakton Ortaku i vetem.

**Neni 19**

Pasuria e Shoqerise pasqyrohet ne bilance me vlere te shprehure ne leke. Ne raste te vecanta vlere e pasurise mund te shprehet edhe ne valute te huaj.

**Neni 20**

Forma e bilancit dhe e aktiviteteve financiare te Shoqerise kryhet

ne përputhje me legjislacionin perkates per kontabilitetin dhe kerkesave te organeve financiare.

**Neni 21**

Shoqeria pergjigjet ndaj shtetit per taksat dhe detyrimet sipas rregullave te caktuara ne legjislacionin shqiptar.

**Neni 22**

Ne zhvillimin e aktivitetit ekonomik Shoqeria mund te beje investime, te marre kredi bankare , konform legjislacionit qe i siguron keto kushte per shoqerite tregtare.

**Neni 23**

Ne ditën e mbarimit te kohezgjatjes se Shoqerise ose me rastin e prishjes se saj, nga Kapitali Themeljar, pasi te jene zbriytur debitet, pjesa qe ngelet i mbetet Ortakut te Vetem.

**Neni 24**

Shoqeria perfiton nga te gjitha lehtesite financiare dhe te pergjithshme te parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

**ORGANET DREJTUESE**

**Neni 25**

Organet drejtuese te Shoqerise jane :

Ortaku i Vetem ,

- Administratori,



Kopetencat dhe funksionimi i tyre do te fiksohen ne Statutin e Shoqerise.

Administratori i Shoqerise eshte Z.VASIL JOVANI.

**VLEFSHMERIA E AKTIT TE THEMELIMIT ( kontrates)**

**Neni 26**

Kohezgjatja e Shoqerise eshte 20 vjet duke filluar nga data e regjistrimit ne Gjykatën e shkalles se pare Tirane. Kontrata mund te zgjatet ne funksion te jetes se Shoqerise dhe konforme legjislacionit ne fuqi.

**DISPOZITA TE FUNDIT**

**Neni 27**

Organet e Shioqerise dhe te gjithë te punesuarit e saj jane te dety-

ruar te respektojne sekretin e informacionit, dokumentacionit dhe te realizimit te shoqerise.

**Neni 28**

Per te gjitha problemet qe nuk rezultojne te parashikuara ne kete Kontrate, do te respektohet legjislacioniu shqiptar ne fuqi.

**Neni 29**

Rregulla me te detajuara per Shoqerine do te percaktohen ne Statutin e saj.

**Neni 30**

Ky akt-themelimi ( Kontrate ) eshte hartuar ne 4 kopje, ne gjuhen shqipe, me vlere te barabarte.

ORTAKU I VETEM

VASIL JOVANI



REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 515 Rep.

Nr. 63 Kol.

**VERTETIM**

Sot me daten 18.03. 2002 ( Dymijeedy ) ne Zyren e Noterise Tirane, u paraqit Vasil JOVANI, i biri i Spiros, lindur ne 25.08.1963 ne Gjirokaster, banues ne Tirane , Rruga "Mihal Grameno", Nr.1, me pashaport Nr.0129350, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i cili deklaroi se sa siper eshte Akti i Themelimit ( Kontrata ) e Shoqerise Tregtare "KRONOS KONSTRUKSION", "SHPK", redaktuar jashte kesaj zyre dhe e nenshkruar para meje, kurse Une Notere e vertetoje ate sipas ligjes.

NOTERE

